



01 Nr. 483/25 Dt. 05.08.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për formimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve të cilët kanë aplikuar në projektin: “Ngritja e pemishtes me pemë arrore” me bashkëfinancim. Anëtarë të këtij Komisioni, emërohen:
 - 1.1. Azem Bilibani,.....kryesues,
 - 1.2. Shaban Krasniqi,.....anëtar,
 - 1.3. Njazim Mustafi,.....anëtar.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi janë: të shqyrtoj dhe vlerësoj të gjitha aplikacionet e fermerëve të cilët kanë aplikuar në projektin: “Ngritja e pemishtes me pemë arrore” me bashkëfinancim, konform thirrjes publike për aplikim, nr. 10-320-94317 të datës 23.07.2025. Komisioni pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve të përshkruar si në pikën 1 dhe 2 të këtij Vendimi, të vendos dhe përcaktoj fituesit e thirrjes publike.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimt të këtij vendimi.
4. Obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Të emëruarve,
- Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

